



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1357/5Prot.

Tiranë, më 18. 11. 2025

V E N D I M

Nr. 265, Datë 18. 11. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 233 regj., datë 15.10.2025, e znj. E. P., kundër Kryetares së Bashkisë Përmet, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, znj. E. P., ka parashtruar se:

“Subjekti që më ka diskriminuar vazhdimisht prej 2 vitesh është A. H., e cila mban postin e Kryetares së Bashkisë Përmet. Unë bazohem në këto rrethana, pasi kam shkuar shpesh në Bashkinë Përmet për të kërkuar punë, pasi portalin nuk kam arritur dot ta bëj, sepse duheshin shumë dokumenta dhe nuk arrita dot t’i gjeja. Më duhej me patjetër një punë, pasi kam 2 fëmijë dhe burri im është i papunë, i shkarkuar nga vetingu. Në zyrën e saj, ditën e pritjes me qytetarët, e cila është caktuar të jetë ditën e enjtes, ajo nuk më ka trajtuar e barabartë me qytetarët e tjerë. Ajo më pret te dera, nuk më lejon të futem brenda, ndërkohë që thërret edhe policin bashkiak, i cili më rri në krah duke më ushtruar presion. Herët e fundit ajo nuk më pret fare, por më nxjerr një sekretare, duke më thënë se “nuk mund t’ju pres kryetarja”. Në raste të tjera mund të përmend kur ajo largohet me nxitim duke zbritur shkallët dhe duke më thënë: “Nuk kam punë për ty, merru me portalet. Tek mua nuk ke punë, shko gjej në një vend tjetër.”

Ky për mua është diskriminim, për shkak se burri im është shkarkuar nga vetingu, dhe në këtë vend, duke qenë se vetingu është nisur nga Partia Socialiste. Personi që ka shkarkuar burrin tim është O. K., i cili tashmë është deputet i Partisë Socialiste dhe përfaqëson atë parti.

Unë, si qytetare, jam privuar nga e drejta për të konkurruar në mënyrë të barabartë për një vend pune. Mua më është cënuar dinjiteti personal, për shkak të trajtimeve me tone fyese dhe përjashtuese, dhe ky trajtim më ka shkaktuar dëme morale dhe shoqërore.

Refuzimi nga ana e Kryetares së Bashkisë Përmet për t'u pranuar në punë nuk është bazuar në kritere profesionale, por në arsyen e procesit të vetingut, i cili është inicuar nga Partia Socialiste, gjë që prek elementin e diskriminimit mbi bazën e lidhjeve familjare, për shkak se burri im ka qenë pjesë e sistemit të drejtësisë.

Veprimet e kryera nga Kryetarja e Bashkisë kanë shkelur nenet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që garantojnë barazinë përpara ligjit dhe të drejtën për punë. Në rastin tim, kjo përbën shkelje të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i cili ndalon shprehimisht diskriminimin për shkak të bindjeve politike apo lidhjeve familjare. Ankesa ime është bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- Konstatimin e diskriminimit nga Kryetarja e Bashkisë Përmet, për shkak të lidhjeve të saj familjare dhe bindjeve të saj politike, të cilat burojnë nga shkarkimi i bashkëshortit të saj nga procesi i vetingut, një proces i inicuar nga Partia Socialiste.
- Bashkisë Përmet t'i kërkohet të ndërpresë çdo formë diskriminimi ndaj saj dhe t'i mundësohet të konkurrojë në mënyrë të barabartë për vendet e punës të shpallura publikisht nga Bashkia Përmet.
- Bashkia Përmet të shqyrtojë kërkesën e saj për punësim në mënyrë të paanshme dhe transparente.
- Nga ana e Komisionerit t'i vendoset gjobë Kryetares së Bashkisë Përmet, në mënyrë që të mos përsëritë veprimet diskriminuese ndaj saj.
- T'i jepet kompensim financiar për dëmin moral dhe shoqëror që i është shkaktuar nga veprimet diskriminuese të Kryetares së Bashkisë Përmet.

Pas regjistrimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me provueshmërinë e disa prej deklarimeve të bëra prej saj kundrejt Bashkisë Përmet.

Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës nr. 1357/2 prot., datë 16.10.2025 të Komisionerit është proceduar me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm për vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj, si më poshtë vijon:

- Informacion dhe dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimit për diskriminim për shkak të bindjeve politike, duke sqaruar natyrën e këtyre bindjeve, mënyrën se si i mbartni dhe i keni demonstruar ato, si dhe lidhjen e tyre me situatën e përshkruar, të gjitha të dokumentuara me fakte dhe prova konkrete
- Shpjegime më të hollësishme në lidhje me shkakun “*çdo shkak tjetër*”, të pretenduar për diskriminim, duke përcaktuar qartë cila është karakteristika, apo veçantia që ju e mbartni dhe që prezumohet të ketë ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju e mbartni këtë shkak të pretenduar.
- Përveç përshkrimit të shkaqeve, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejtë në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tij.
- Të na vini në dispozicion informacion nëse keni aplikuar për vendet vakante të shpallura nga bashkia, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe afatet e përcaktuara, duke bashkëngjitur kopje të shpalljeve përkatëse, aplikimit tuaj dhe çdo përgjigje zyrtare të marrë në lidhje me to. Gjithashtu, ju lutemi të sqaroni nëse niveli dhe profili juaj arsimor kanë qenë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këto shpallje.
- Informacion nëse i jeni drejtuar Bashkisë Përmet me ndonjë ankesë lidhur me pretendimin për diskriminim në procesin e shqyrtimit të kërkesës suaj për punësim. Nëse po, ju lutemi të paraqisni kopje të ankesës së paraqitur, çdo përgjigje të marrë nga bashkia, si dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Nëpërmjet e-mailit të datës 18.10.2025, ankuesja ka përcjellë pranë Komisionerit një kopje të e-mailit të dërguar Bashkisë Përmet, me anë të së cilës ka kërkuar t’i vihej në dispozicion informacion lidhur me kërkesën e saj për punësim.

Gjithashtu, me shkresën nr. 1415 prot., datë 08.10.2025, është administruar pranë Komisionerit nga ankuesja një kopje e përgjigjes së kthyer nga Bashkia Përmet, në lidhje me kërkesën për punësim të paraqitur nga znj. P.

Megjithatë, znj. P., nuk iu përgjigj të gjitha kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në lidhje me sqarimet dhe dokumentacionin e kërkuar.

Në këto kushte, për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri është bazuar në analizën e dokumentacionit të administruar dhe të parashtrimeve të depozituara nga subjekti ankues në ankesën me nr. 233 regj., datë 15.10.2025.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në bazë të nenit 12/1/c, të ligjit, parashikohet se: “Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja, si dhe referuar kronologjisë së ngjarjeve të pasqyruara në këto akte, Komisioneri konstaton se:

- Me kërkesën nr. 2286 prot., datë 15.07.2025 rezulton që ankuesja të ketë bërë një kërkesë për punësim pranë Bashkisë Përmet.
- Me shkresën nr.2286/1 prot., datë 24.07.2025 nga ana e Bashkisë Përmet i është kthyer përgjigje ankueses, ku citohet se: *Mbështetur në kualifikimet tuaja në profilin mësuese e gjuhës angleze, ju duhet të hyni në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe ti drejtoheni ZVA Përmet-Këlcyrë. Shpalljet për vendet vakante, mund ti ndiqni në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet dhe pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.*
- Me kërkesën nr. 3306 prot., datë 09.10.2025 rezulton që ankuesja të ketë bërë një kërkesë tjetër për punësim pranë Bashkisë Përmet duke pretenduar se në bibliotekën e Përmetit mund të lirohet një pozicion pune.

Referuar pretendimeve të paraqitura nga ankuesja, si dhe dokumentacionit të administruar dhe të shqyrtuar në kuadër të kësaj çështjeje, rezulton se, deri në momentin e regjistrimit të ankesës së znj. P., pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), nuk ka pasur një procedurë të zhvilluar për ndonjë pozicion vakant të shpallur nga ana e Bashkisë Përmet, për të cilin mund të kërkoreshin kriteret dhe kualifikimet që i përshtaten ankueses.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar dhe e rrethanave të paraqitura në këtë rast, Komisioneri vlerëson se kërkesat e paraqitura nga znj. P., pranë Bashkisë Përmet përbëjnë shprehje të interesit personal për t’u punësuar pranë kësaj njësie të vetëqeverisjes vendore, dhe nuk lidhen me ndonjë procedurë të shpallur zyrtarisht për punësim nga ana e Bashkisë. Në momentin e paraqitjes së këtyre kërkesave, nuk rezulton të ishte shpallur asnjë vend vakant, për të cilin znj. P., mund të aplikonte në përputhje me kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara. Si rrjedhojë, komunikimet ndërmjet palëve nuk mund të konsiderohen pjesë e një procedure rekrutimi apo përzgjedhjeje të nisur nga institucioni i bashkisë, por vetëm korrespondencë administrative informative, e cila ka për qëllim dhënien e sqarimeve lidhur me mënyrat dhe kanalet e ligjshme për aplikim në pozicione pune pranë Bashkisë Përmet.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara më sipër, të dokumentacionit të depozituar dhe të pretendimeve të paraqitura nga subjekti ankues, nuk rezulton të ketë informacion apo prova të mjaftueshme që të vërtetojnë faktin se Bashkia Përmet ka zbatuar, apo do të zbatojë, një procedurë të parregullt lidhur me shpalljen e ndonjë pozicioni vakant, apo se do të ndërmarrë një vendimmarrje të pabazuar në ligj.

Në këto kushte, KMD, vë në dukje faktin se për shqyrtimin e kësaj ankese nuk ekzistojnë indicie të mjaftueshme për të filluar një procedim administrativ. Në parim, duhet të ekzistojnë fakte dhe prova konkrete që dëshmojnë për trajtim të pabarabartë, si dhe duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për të iniciuar një hetim administrativ¹.

¹ Për analogji citojmë Vendimin nr. 205, datë 22.07.2024, të KMD-së.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga znj. E. P., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA